

# Einführung

## Hyrje

### ● Pse është i nevojshëm ky libër shoqërues?

Ky është libri i Pjesës së Dytë të kursit të gjermanishtes në radio, *Deutsch – warum nicht?* Ai shoqëron mësimet që transmetohen në radio dhe na ndihmon sa herë që dëshirojmë të rilexojmë ose të thellojmë diçka. Në këtë kurs, rëndësi kryesore i jepet dëgjimit në radio. Prandaj gjithnjë këshillohet që në fillim të dëgjohet kursi në radio për t'u njohur më mirë me situatën. Në çdo emision ne bëjmë pyetje të ndryshme, që ndihmojnë për t'u përqëndruar në çështjet kryesore dhe për të kuptuar më mirë vazhdimin e bisedës (situatën, rendin, personat që flasin, temat, mjedisin) Përqëndrohuni te këto pyetje! Mos u përpiqni të kuptoni patjetër çdo fjalë: kjo mund t'ju dekurajojë shpejt, sepse është vështirë t'i kuptoni të gjitha me të parën.

### ● Ç'është e re dhe çfarë nuk ka ndryshuar në Pjesën e Dytë?

Në Pjesën e Dytë mjaft gjëra janë të ngjashme me Pjesën e Parë. Në të vërtetë Pjesa e Dytë mbështetet mbi ato baza që u përvetësuan në Pjesën e Parë. Ju do të gjeni këtu të njëjtat personazhe kryesore, por natyrisht në situata të ndryshme. Raportet, marrëdhëniet midis personazheve tashti do t'ju duken më të afërta. Do të mësoni gjithashtu se cila është e fshehta e Eksës. Ndoshta ju kujtohet se Eksa është një personazh femëror imagjinar, e padukshme dhe që shpesh i nervozon dhe i bezdis të tjerët.

Struktura dhe ecuria e këtyre mësimëve janë të ngjashme me ato të Pjesës së Parë ... por në fund të kësaj pjese do të konstatooni se ne nuk i përkthejmë më dialogët fjalë për fjalë. Ne bëjmë një përmbledhje sinoptike të tyre.

Në gjashtë emisionet e para ne do të bëjmë një përsëritje të disa çështjeve kryesore të gramatikës së Pjesës së Parë. Fjalori që përfshihet në Pjesën e Parë nuk do të përsëritet. Dialogët janë përkthyer të plotë në librin shoqërues, kështu që ju do të keni mundësinë t'i gjeni fjalët e panjohura në kontekstin ku përdoren. Fjalori alfabetik që ndodhet në fund të librit përmban vetëm fjalët dhe shprehjet që ndeshen në Pjesën e Dytë.

### ● Përmbajtja e këtij libri shoqërues.

#### A Të dhëna për mësimet e ndryshme

##### 1. Një përmbledhje e gramatikës

Kjo përmbledhje përmban çështjet gramatikore dhe shprehjet kryesore të çdo mësimi. Gramatika është shpjeguar me hollësi me shprehje të nxjerra nga mësimi.

## 2. Dialogët e çdo mësimi

Tekstet e dialogëve janë shtypur gjermanisht. Kështu ju mund të rilexoni tekstin e dëgjuar në radio. Për të lehtësuar të kuptuarit, para dialogëve janë dhënë disa shpjegime në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë, nëse ju nuk keni mundur të ndiqni një emision në radio, mund t'i lexoni dialogët në librin shoqërues.

## 3. Fjalë dhe shprehje

Të gjitha fjalët dhe shprehjet e reja që ndeshen në secilin mësim janë paraqitur në formë liste pas dialogëve (në gjermanisht) të çdo mësimi. Fjalët dhe shprehjet që janë përdorur në mësimet e mëparshme ose në Pjesën e Parë, si rregull nuk rimerren. Në rast nevojë ju mund t'i referoheni listës alfabetike në fund të librit. Në disa raste mund të ndeshni në listë fjali si kjo: *Ich möchte mit dir / Ihnen / ... / ins Theater / ins Museum / ... / gehen.* Fjalët dhe shprehjet midis dy vijave të pjerrëta (/ /) mund të futen në fjali për ta plotësuar atë (si zgjidhje alternative). Pikat e heshtjes (...) tregojnë se ju vetë duhet të gjeni shembuj të ngjashëm. Si p.sh.:

Ich möchte mit dir ins Theater gehen.

Ich möchte mit Ihnen ins Theater gehen.

Ich möchte mit ihm ins Theater gehen.

Ich möchte mit dir ins Museum gehen.

Ich möchte mit Ihnen in die Oper gehen.

Në këtë mënyrë ju mësoni një strukturë së cilës mund t'i referoheni më vonë dhe ta përdorni në situata të ndryshme.

## 4. Ushtrime

Ushtrimet në pjesën më të madhe janë ushtrime gramatikore, por libri përmban gjithashtu ushtrime për fjalorin dhe përdorimin e drejtë të shprehjeve. Çelësi i këtyre ushtrimeve ndodhet në fund të këtij libri. Duke avancuar mësimet ju do të gjeni ushtrime që bazohen në struktura më të lira dialogësh. Do t'ju jepen fillime bisedash, të cilat ju duhet t'i plotësoni duke formuar dialogë. Natyrisht, për këto tipe ushtrimesh nuk jepen zgjidhje në çelësin e ushtrimeve.

## B Përmbledhje e gramatikës

Kjo është një përmbledhje e gramatikës që kemi hasur gjatë mësimeve. Pikërisht në gramatikën e Pjesës së Dytë janë koha e kryer e foljeve dhe rasta dhanore. Disa nga çështjet gramatikore janë paraqitur në formë tabelash.

## C Çelësi i ushtrimeve

## D Përkthimi i dialogëve

Dialogët e mësimeve i gjeni këtu të përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo ju ndihmon për të kuptuar, veçanërisht kur nuk keni ndjekur mësimet e Pjesës së Parë dhe nuk e keni librin shoqërues të Pjesës së Parë.

## E Fjalori alfabetik

Ky fjalor përmban të gjitha fjalët e reja të Pjesës së Dytë të kursit. Në kllapa jepet numri i mësimit në të cilin këto fjalë hasen për herë të parë. Fjalët e Pjesës së Parë nuk janë përsëritur në këtë nënndarje.

## F Lista e foljeve dhe e pjesores së shkuar të tyre

Kjo listë përmban të gjitha foljet e Pjesës së Parë dhe të Dytë në paskajore, në formën e tyre përfaqësuese, por edhe në pjesoren II, d.m.th në pjesoren e shkuar. Shumica e foljeve të gjermanishtes e formojnë kohën e kryer me foljen ndihmëse *haben*, të ndjekur nga pjesorja e shkuar. Prandaj, ato folje që e formojnë kohën e kryer me foljen ndihmëse *sein* janë shënuar në një mënyrë të veçantë; *sein* është vendosur në kllapa pas pjesores së shkuar. Për shembull:

sehen – gesehen

kommen – gekommen <sein>


Ju uroj kënaqësi dhe sukses në kursin tonë *Deutsch – warum nicht?*

Herrad Meese

# Einige Informationen

## Disa tē dhēna

### I Hartē e Ahenit (Aachen)



## 2 Ditët e javës

1	Mo	Montag / E hënë	
2	Di	Dienstag / E martë	
3	Mi	Mittwoch / E mërkurë	
4	Do	Donnerstag / E enjte	
5	Fr	Freitag / E premte	
6	Sa	Samstag, Sonnabend / E shtunë	das Wochenende
7	So	Sonntag / E diel	Fundjavë

Wann? Am Montag, am Dienstag, ... montags, dienstags, ...  
Kur?

## 3 Numërorët rreshtorë

### Emërore

1.–10.	11.–20.	21.–30.	10.–100.
1. <b>erste</b>	11. <b>elfte</b>	21. <b>einundzwanzigste</b>	10. zehnte
2. <b>zweite</b>	12. <b>zwölfte</b>	22. <b>zweiundzwanzigste</b>	20. zwanzigste
3. <b>dritte</b>	13. <b>dreizehnte</b>	23. <b>dreiundzwanzigste</b>	30. dreißigste
4. <b>vierte</b>	14. <b>vierzehnte</b>	24. <b>vierundzwanzigste</b>	40. vierzigste
5. <b>fünfte</b>	15. <b>fünfzehnte</b>	25. <b>fünfundzwanzigste</b>	50. fünfzigste
6. <b>sechste</b>	16. <b>sechzehnte</b>	26. <b>sechszwanzigste</b>	60. sechzigste
7. <b>siebte</b>	17. <b>siebzehnte</b>	27. <b>siebenundzwanzigste</b>	70. siebzigste
8. <b>achte</b>	18. <b>achtzehnte</b>	28. <b>achtundzwanzigste</b>	80. achtzigste
9. <b>neunte</b>	19. <b>neunzehnte</b>	29. <b>neunundzwanzigste</b>	90. neunzigste
10. <b>zehnte</b>	20. <b>zwanzigste</b>	30. <b>dreißigste</b>	100. hundertste

der erste Chef  
shefi i parë

die erste Studentin  
studentja e parë

das erste Buch  
libri i parë

### Kallëzore

den **ersten** Chef

die **erste** Studentin

das **erste** Buch

### Dhanore

mit dem **ersten** Chef, mit der **ersten** Studentin, mit dem **ersten** Buch

## 4 Ngjyrat

blau / blu	orange / portokalle
gelb / e verdhë	rot / e kuqe
grau / gri	schwarz / e zezë
grün / e gjelbër	weiß / e bardhë
lila / lejla	

Welche Farbe möchten Sie?  
Çfarë ngjyre dëshironi?

Haben Sie die Bluse auch in Gelb?  
Keni si kjo bluzë në ngjyrë të verdhë?

## 5 Ora



sieben Uhr

**19.00**

neunzehn Uhr



zwölf Uhr  
(mittags = Mesditë)

**24.00**

Mitternacht / Mesnatë



neun Uhr

**21.00**

einundzwanzig Uhr



halb zehn  
neun Uhr dreißig

**21.30**

einundzwanzig Uhr dreißig



Viertel vor zehn

**9.45**

neun Uhr fünfundvierzig



Viertel nach zehn

**10.15**

zehn Uhr fünfzehn



fünf vor zehn

**9.55**

neun Uhr fünfundfünfzig



fünf nach zehn

**10.05**

zehn Uhr fünf

Wieviel Uhr ist es?  
Sa është ora?

Zehn (Uhr).  
Dhjetë.

Wann kommt er?  
Kur vjen ai?

Um zehn (Uhr).  
Në orën dhjetë.